

**STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“CRYPTO” SH.P.K**

Ne cilesine ortakeve themelues dhe ne pajtim te plote me dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 , per “Tregtaret dhe shoqerite tregtare “,ligji nr 9723 date 03.05.2007 per “Qendren Kombetare te Regjistrimit” dhe neneve 324 deri 326 te K.Pr.C te Republikes se Shqiperise:

Z.Adnan Kurtulus , i datelindjes 01.12.1961 ,lindur ne Ankara ,me shtetesi turke , mbajtes i pasaportes me nr 07435132 .

**Neni 1**

**Emertimi Shoqerise**

Sot, më 27.08.2020 vendos te themeloje një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin Crypto SH.P.K.

Shoqeria eshte person juridik dhe ushtron aktivitetin veprimtarine ne baze te ligjit Nr 9901,date 14.04.2008 ” per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

**Neni 2**

**Selia e Shoqerise**

Selia e shoqerise “ Crypto” SH.P.K eshte ne adresen “ Sulejman Delvina , prane postes nr 8 dyqani nr 2 ,Tirane .Shoqeria mund te ushtroje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Shqiperise ashtu dhe jashte saj.Shoqeria sipas parashikimeve te ketij statute dhe legjislacioni ne fuqi mund te hap ne Shqiperi edhe jashte saj,qendra , perfaqesi apo filiale, dege dhe shoqeri te tjera.



### **Neni 3**

#### **Kohezgjatja e veprimtarise**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te papercaktuar.

### **Neni 4**

#### **Objekti Veprimtarise**

Shoqeria do te kete si objekt veprimtarie :

Import-export, transaksione financiare, konsulence financiare, konsulence ligjore, konsulence teknike ne fushen e ndertimit dhe zbatimit, shitje dhe blerje, tregti makinash, shitje dhe blerje pasurive te paluajtshme, tregti dhe konsulence te materialeve te mineraleve dhe gureve te cmuara, tregti te produkteve farmaceutike, produkte financiare dhe cdo gje te lejuar nga ligji. Veprimtari komisionere, ndermjetesimi, perfaqesimi, konsulence.

Hyrja ne tratativa dhe biznese me shoqeri te tjera qe kane te njejtin objekt veprimtarie. Krijimi, blerja, financimi, investimi, hyrja ne mardhenie te ndryshme me te tretet, kryerja e siper marrjeve dhe projekteve, ofrimi i sherbime dhe asistences se te gjitha llojeve, personave fizike dhe juridike, perfshi sherbimet menaxhuese, keshilluese, planifikuese, financiare, turistike, teknike, administrative.

Do te ofroje sherbime, per anetaret nepermjet grumbullimit te produkteve dhe gjetjen e tregut te shitjes, per rrushin, frutat, perimet.

Sherbime bujqesore, si plugime, sperkatje etj, si dhe eksport import sipas nevojave qe lindin. Mbjellje, rritje, dhe perpunim te te gjitha prodhimeve bujqesore per te realizuar sasi me te medha prodhimi me qellim hyrjen ne treg.

Import dhe eksport te te gjitha prodhimeve bujqesore te fresketa, blerjen e farave, fidaneve, medikamenteve per mbrojtjen nga semundjet dhe demtuesit. Ngritjen e industrise perpunuese. Permiresimin dhe organizimin per kultivimin e specave, domateve, kastravecit..etj me qellim rritjen e sasise dhe cilesise se prodhimit si dhe te tregtimit te produkteve te tyre.

Nxitjen dhe organizimin e te gjitha aktiviteteve qe kane te bejne me prodhimin dhe tregetimin e prodhimeve te fermereve. Sigurimin dhe furnizimin e fermereve me inpute cilesore dhe me cmime te favorshme.

#### **Neni 5**

#### **Kapitali Regjistruar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku themelues : Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kalimi i kuotave miratohet nga asambleja e ortakëve të shoqërisë duke u bazuar në dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

### **Neni 8**

#### **Organi Vendimmarres**

1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2.Ortaku nuk mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

## **Neni 9**

### **Perfaqesimi**

Administratori shoqerise “ CRYPTO “ SH.P.K do te jete Z.Adnan Kurtulus.

Administratori kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise tregtare dhe perfaqeson shoqerine perball te treteve.

## **Neni 10**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e Ortakeve mund te marre vendim per ndryshimin e statutit , zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar , shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

## **Neni 11**

### **Viti financiar dhe ekspertet**

1.Veprimet ekonomike te shoqerise do te mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti.Ne fund te cdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel dhe rezultati ekonomik humbje/fitim.Bilanci kontabel miratohet brenda dates 31 Mars te vitit pasardhes dhe pas pagimit te detyrimeve fiskale pjesa qe ngelet I jepet per perdorim asamblese se ortakeve te shoqerise.

2.Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithhevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te



ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Neni 12**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

***ORTAKET***  
***E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***  
***\* CRYPTO SH.P.K\****

---

*Emer mbiemer*

*(nenshkrimi)*

Adnan Kuatullari  


